

## Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

### KËTË JAVË:

- Dështon kërcënimi i Thaçit për demarkacion
- Pasuria e Kosovës as nuk falet, as nuk vidhet
- Koalicioni LDK-PDK-SRPSKA po e shtron rrugën për 'Zajednicë'
- Ylli Hoxha zgjidhet kryetar i Qendrës së Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë

### Dështon kërcënimi i Thaçit për demarkacion

Javë më parë, Hashim Thaçi i dha 10 ditë kohë Kuvendit të Kosovës për ta ratifikuar marrëveshjen për demarkacion me Malin e Zi.

Ndaj këtij kërcënimi kishte reaguar më parë Lëvizja VETËVENDOSJE! si dhe deputetët e saj. Kur ky afat kohorë tashmë kaloi reagoi sërish edhe kryetari i Lëvizjes VETËVENDOSJE! i cili tha se dështim i kërcënimit të tij, është një argument më shumë për t'i thënë "i ashtuquajtur President!", pasi që Presidenti i vërtetë dorëhiqet kur dështon.




"Së dyti, kriter më i rëndësishëm për BE-në se demarkacioni me Malin e Zi është luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit të lartë, e ku bën pjesë vetë Thaçi me vëllezër e me shokë. Thaçi duhet të mbetet pa vizë në Kosovë në mënyrë që qytetarët e Kosovës të marrin viza për BE." tha ai

Më tej në reagim Ymeri tha se Thaçi e ka lidhur karrierën e tij për humbjen e territorit të Kosovës. "Midis asaj se a duhet ta humbim këtë të ashtuquajtur president apo 8.200 hektarë, qytetarët e deputetët nuk duhet të kenë dilema."

### Pasuria e Kosovës as nuk falet, as nuk vidhet

Në fundjavë aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! zhvilluan një aksion simbolik në lidhje me marrëveshjen e dëmshme të demarkacionit me Malin e Zi. Në këtë aksion që u krye afër banesës ku jeton presidenti Hashim Thaçi, aktivistja

Teutë Rrusta tha se Thaçi nuk mund ta falë tokën e Kosovës, madje ai duhet ta kthejë pasurinë e vjedhur bashkë me vëllezërit e tij.



"Sot kemi ardhur në një pikë që nuk kemi pse i diskutojmë faktet që dëshmojnë humbjen e një pjese të territorit të Kosovës nga marrëveshja për demarkacion. Ajo çfarë duhet vënë në pah vazhdimisht është lidhja në mes të fatit të Hashim Thaçit në politikë përmes faljes së territorit", tha Rrusta.

Hashim Thaçi ka shumë prona, pasuri e rrjet të organizuar për këtë gjë. Në ndërkohë që ai fal tokë të Kosovës që të bëhet president, dhe nuk e pranon gabimin në mënyrë që të vazhdojë të jetë president. Ndërkohë, atij i duhet të mbetet president që të mos jetë prapa grilave.



"Thaçi e përdor pozitën e Presidentit për t'u arratisur nga burgu", shtoi ajo.

Qeveria Mustafa, nga dy kushtet kryesore për liberalizim përmend vetëm njërin, atë të demarkacionit, por kushti tjetër nga BE-ja është luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Nuk do të lejojmë, në asnjë mënyrë dhe për asnjë çmim që të ratifikohet kjo marrëveshje. Ne do ta përdorim tërë kapacitetin tonë mendor e organizativ për ta penguar një gjë të tillë.

### Koalicioni LDK-PDK-SRPSKA po e shtron rrugën për 'Zajednicë'

Koalicioni PDK-LDK-SRPSKA në bashkëveprim të koordinuar me njëri tjetrin po thellojnë ndarjen e Kosovës në veri e jug,

Nr. 470, 13 korrik 2016

duke ia shtruar shtratin 'Zajednicës' së Serbisë në Kosovë. Në ndërkohë atje po ndodhë sërish rikonizimi i papenguar përmes ndërtimit të lagjeve me kolonë të rinj, po ndodhë serbizimi i historisë përmes ndërtimit të përmendoreve të Kralëve e Carëve serb atje. E Ministrat e Qeverisë së Mustafës marrin pjesë në zbulimin e shtatoreve të carit në Mitrovicë, prenë shirite në lagjen e luginës së diellit, e shefi i tyre kryeministër i dënon ashpër me një status në 'facebook'. E për ta dëshmuar edhe njëherë se këta vazhdojnë rrugën e Millosheviqit, themeluesi i kësaj liste, Jabllanoviq shkoi deri në Kosharen historike për t'iu thurur lavdi ushtarëve pushtues që vrisnin shqiptarë në luftën e Kosovës duke vënë lule ku u vranë barbarët. Qeveria prapë heshtë. Kolegë të mazhorancës ja kush janë partnerët tuaj të koalicionit. Ata nuk kanë ndryshuar nga vitet e nëntëdhjeta. Ashtu siç Serbia mbetet Serbi për Kosovën dhe Shqiptarët e njëjta sikur në kohen e Millosheviqit.

### Ylli Hoxha zgjidhet kryetar i Qendrës së Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë

Javës që shkoi, në Qendrën e VETËVENDOSJE! në Prishtinë votuan rreth 900 anëtarë, të cilët zgjodhën Ylli Hoxhën për kryetar të kësaj qendre.



"Demokracia e brendshme në Lëvizje është shembull për demokracinë në përgjithësi në vendin tonë. Jemi i vetmi subjekt ku secili anëtar ka të drejtë vote, jo vetëm për të zgjedhur drejtuesit e organizatës sonë, por edhe për të vendosur përmes referendumit të brendshëm, mbi çështjet dhe proceset e e rëndësishme në Lëvizje." thuhej në komunikatën e kësaj Qendre.

Në Prishtinë, gjatë këtij procesi zgjedhor u themeluan 22 pika nëpër lagjet e qytetit dhe fshatrat e komunwvs.